

BANKA E SHQIPËRISË

B U L E T I N I
Z Y R T A R

vëllimi 26 numër 1 janar 2024

Data e botimit: 23.2.2024

P Ë R M B A J T J A

1. Licencë nr. 55, datë 03.11.2023, "Për të vepruar si institucion i parasë elektronike në Republikën e Shqipërisë"	5
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 2, datë 24.1.2024, për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit për Sistemet e Pagesave"	7
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 3, datë 24.1.2024, "Për miratimin e disa ndryshimeve në kontratën tip për riblerjen e titujve"	12
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 5, datë 24.1.2024 "Për miratimin e Strategjisë të Bankës së Shqipërisë "Për krijimin e monedhave pa kurs ligjor, përkujtime dhe për qëllime numizmatike për 2024-2029""	16
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 6, datë 24.1.2024 "Për miratimin e Strategjisë të Bankës së Shqipërisë për edukimin dhe përfshirjen financiare, 2024-2026"	24
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 7, datë 24.1.2024 "Për miratimin e delegimit të kompetencës për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bankës së Shqipërisë dhe Akademisë së Sigurisë"	48



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË

LICENCË
Nr. 55, datë 3.11.2023

PËR TË VEPRUAR SI INSTITUCION I PARASË ELEKTRONIKE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020 "Për shërbimet e pagesave" si dhe të rregullores "Për licencimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, si dhe për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave" miratuar me vendim nr. 59, datë 24.11.2021 të Këshillit Mbikëqyrës, Banka e Shqipërisë i jep shoqërisë "BKT PAY" sh.a. licencën si institucion i parasë elektronike për të ushtruar veprimtaritë financiare të përshkruara në aneksin bashkëlidhur.

Licenca është e pakufizuar në kohë dhe nuk është e transferueshme ose e tjetërsueshme.

GUVERNATORI

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË

Tiranë, më 3.11.2023

ANEKS

LICENCA NR. 55

VEPRIMTARITË E LEJUESHME PËR "BKT PAY" SH.A.

Institucioni i parasë elektronike "BKT PAY" sh.a., në bazë të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020 "Për shërbimet e pagesave"; dhe të rregullores "Për licencimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, si dhe për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave" miratuar me vendim nr. 59, datë 24.11.2021 të Këshillit Mbikëqyrës, është licencuar të kryejë veprimtarinë financiare:

- Emetimi i parasë elektronike.

GUVERNATORI

GENT SEJKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 2, datë 24.1.2024

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETIT PËR SISTEMET E
PAGESAVE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3, pika 4, shkronja “dh”, nenit 21, pika 4 dhe nenit 43, shkronja “f” të ligjit nr. 8269 datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 10, pika 4 të Statutit të Bankës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr. 90, datë 2.12.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, i ndryshuar; të neneve 6 - 12 të rregullores “Mbi rregullat procedurale të Bankës së Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr. 37, datë 16.5.2001 të Këshillit Mbikëqyrës; me propozimin e Guvernatorit dhe të Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit për Sistemet e Pagesave”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Komiteti për Sistemet e Pagesave në Bankën e Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi dhe të rregullores në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO

Neni 1 Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të organizimit dhe të funksionimit të Komitetit për Sistemet e Pagesave (Komiteti).

Neni 2 Baza ligjore

Zbatimi i kësaj rregullore bëhet në përputhje me kërkesat e akteve të mëposhtme:

- a) ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- b) Statutit të Bankës së Shqipërisë;
- c) rregullores së Këshillit Mbikëqyrës "Mbi rregullat procedurale të Bankës së Shqipërisë".

Neni 3 Qëllimi

Komiteti, nëpërmjet veprimtarisë së tij, ka si qëllim koordinimin e punës së Bankës në fushën e sistemeve të pagesave dhe të shlyerjes, duke këshilluar dhe asistuar administratorët për zhvillimin e politikave afatmesme, për ngritjen dhe funksionimin e infrastrukturave të reja, si dhe për përgatitjen e kuadrit rregullator në fushën e sistemeve të pagesave dhe të shlyerjeve, brenda kompetencave të Bankës dhe në përputhje me objektivin ligjor të Bankës për nxitjen e funksionimit normal të këtyre sistemeve.

Neni 4 Detyrat e Komitetit

Për realizimin e qëllimit të përcaktuar në nenin 3, Komiteti kryen detyrat e mëposhtme:

- a) mbështetur në propozimet e departamenteve të përfshira, Komiteti këshillon administratorët mbi prioritetet e politikave që duhet të ndërmarrë Banka në fushën e sistemeve të pagesave dhe të shlyerjeve, të cilat lindin si nevoja të zhvillimit të tregut të brendshëm financiar, ndryshimeve teknologjike, angazhimeve institucionale dhe janë në përputhje me Strategjinë Afatmesme të Zhvillimit të Bankës;
- b) lehtëson punën brenda Bankës për implementimin e sistemeve/ zgjidhjeve të reja për procesimin e pagesave dhe transfertave; për përgatitjen e kuadrit rregullator në fushën e pagesave në përputhje me respektimin e angazhimeve të Bankës në procesin e integritet evropian;
- c) diskuton dhe jep opinion mbi fizibilitetin e projekteve të propozuara

- nga DSPKF apo nga departamente të tjera, të cilat prekin çështje të sistemeve të pagesave dhe të shlyerjeve, si dhe ato të përdorimit të instrumenteve të pagesave;
- d) mund të propozojë për ngritjen e grupeve të punës në Bankë për realizimin e projekteve në fushën e sistemeve të pagesave dhe të instrumenteve të pagesave, duke orientuar departamentin përkatës mbi përbërjen e urdhrit të grupit të punës. Komiteti përcakton objektivat, afatet dhe mënyrën e raportimit pranë Komitetit;
 - e) monitoron rregullisht ecurinë e realizimit të projekteve, nëpërmjet informimit nga departamentet e përfshira ose grupet e punës, si dhe jep rekomandimet përkatëse;
 - f) diskuton mbi administrimin e rreziqeve të aspekteve të mirëfunksionimit me qëllim nxitjen e sigurisë, qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e sistemeve të pagesave, dhe lidhjen e tyre me tregjet financiare dhe implikimet për stabilitetin financiar, në rast se evidentohen rreziqe të shtuara;
 - g) kërkon informacion rregullisht mbi veprimtarinë e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave (KKSP), nëpërmjet sekretariatit të tij, me qëllim bashkërendimin e aktiviteteve të Bankës me ato të KKSP, shmangien e mbivendosjes së burimeve dhe krijimin e sinergjive;
 - h) detyra të tjera që i shërbejnë qëllimit të krijimit të tij.

Neni 5 Përbërja e Komitetit

1. Komiteti përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:
 - a) Guvernatori, në cilësinë e Kryetarit të Komitetit;
 - b) Zëvendësguvernatori i Parë, në cilësinë e Zëvendëskryetarit të Komitetit;
 - c) Drejtori i Departamentit të Sistemeve të Pagesave Kontabilitetit dhe Financës;
 - d) Drejtori i Departamenti i Mbikëqyrjes;
 - e) Drejtori i Departamentit të Teknologjisë së Informacionit;
 - f) Drejtori i Departamentit të Operacioneve Monetare;
 - g) Drejtori i Departamentit të Stabilitetit Financiar; dhe
 - h) Drejtori i Departamentit Juridik.
2. Komiteti kryesohet nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë në cilësinë e kryetarit. Zëvendëskryetar është Zëvendësguvernatori i Parë.
3. Guvernatori përcakton me urdhër anëtarët e tjerë të Komitetit, si dhe sekretarin.
4. Në rast mungese të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, funksioni i kryetarit të Komitetit kryhet nga Zëvendëskryetari. Në rast mungese të të dy titullarëve, në rolin e kryetarit të mbledhjes zgjidhet, me shumicë të thjeshtë votash, njëri prej anëtarëve të tjerë të Komitetit.
5. Çdo anëtar i Komitetit, në rast mungese, ka të drejtë të autorizojë një person tjetër për ta përfaqësuar në mbledhjet e Komitetit.

Kryetari njoftohet për çdo rast. Zëvendësuesi ka të njëjtat të drejta dhe detyrime si i zëvendësuari.

6. Me kërkesën e të paktën njërit prej anëtarëve dhe miratimin e Kryetarit, në mbledhjen e Komitetit mund të ftohen të marrin pjesë me të drejtë konsultative, punonjës të ndryshëm të Bankës. Prezenca e tyre evidentohet në procesverbalin e mbledhjes.

Neni 6 Mbledhjet e Komitetit

1. Komiteti mblidhet, si rregull, të paktën çdo 3 muaj. Ai mund të mblidhet sa herë që gjykohet e nevojshme nga Kryetari i Komitetit, me propozim të DSPKF ose të një anëtari.
2. Data e mbledhjes caktohet nga Kryetari. Komiteti zhvillon mbledhjen me praninë e të paktën gjysmës së anëtarëve.
3. Në varësi të rendit të mbledhjes, materialet apo prezantimet e nevojshme i vihen në dispozicion Komitetit nga sekretari të paktën dy ditë përpara mbledhjes.
4. Vendimet dhe rekomandimet e Komitetit dakordohen me shumicë të thjeshtë votash. Vota e Kryetarit është përcaktuese në rast barazie të votave.
5. Në rast të pamundësisë për grumbullimin fizik të anëtarëve, shprehja e qëndrimit të anëtarëve për propozimet e dërguara, bëhet nëpërmjet postës elektronike.
6. Diskutimet dhe vendimet/rekomandimet/këshillimet e mbledhjes së Komitetit pasqyrohen në procesverbalin e mbajtur nga sekretari dhe nënshkruhen prej tij dhe Kryetarit. Procesverbali hartohet në dy njësi, ku një kopje dërgohet në zyrën e Arkiv-Protokollit dhe një kopje tek Guvernatori.

Neni 7 Sekretari i Komitetit dhe detyrat e tij

1. Sekretari merr pjesë në mbledhjet e Komitetit, por nuk ka të drejtën e votës.
2. Sekretari i Komitetit ushtron detyrat e mëposhtme:
 - a) vë në dispozicion të çdo pjesëmarrësi në mbledhje materiale mbi çështje që do të diskutohen, të paktën dy ditë para datës së zhvillimit të mbledhjes;
 - b) pasqyron mendimet dhe diskutimet e pjesëmarrësve në mbledhjen e Komitetit në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim;
 - c) shpërndan me postë elektronike procesverbalin, merr dakordësinë e anëtarëve të pranishëm në mbledhje mbi përmbajtjen e tij, e nënshkruan atë së bashku me drejtuesin e mbledhjes në dy njësi;
 - d) dërgon një njësi të procesverbalit të mbledhjes në Zyrën e Arkiv-Protokollit dhe një njësi pranë zyrës së Guvernatorit.

3. Krahas detyrave të përcaktuara në këtë nen dhe në përputhje me funksionin e tij në Komitet, sekretari mund të kryejë edhe detyra të tjera që mund t'i caktohen nga Kryetari i Komitetit.

Neni 8 Konfidencialiteti

1. Të gjitha dokumentet dhe informacionet që kanë lidhje me mbledhjet e Komitetit përbëjnë informacion jopublik profesional dhe trajtohen në përputhje me rregulloren e Këshillit Mbikëqyrës "Për transparencën dhe konfidencialitetin në Bankën e Shqipërisë" dhe udhëzimin e Guvernatorit "Mbi rregullat për përdorimin dhe klasifikimin e informacionit "sekret bankar" në Bankën e Shqipërisë".
2. Kryetari i Komitetit ka të drejtë të vendosë për t'u mundësuar palëve të interesuara njohjen me këtë informacion, në mënyrë të plotë ose të pjesshme, si dhe në një formë të përshtatshme, kur kjo nuk ndalohet nga kërkesat përkatëse të akteve rregullative.

Neni 9 E fundit

Me zbatimin e kësaj rregulloreje ngarkohet Komiteti dhe Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 3, datë 24.1.2024

PËR
MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË KONTRATËN TIP PËR RIBLERJEN E
TITUJVE

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kreut IV të ligjit nr. 133, datë 29.04.2013 "Për sistemin e pagesave", bazuar në propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në Kontratën Tip për riblerjen e titujve, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 15, datë 10.03.2010, bëhen ndryshimet sipas aneksit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare, Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, si dhe bankat me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare në Bankën e Shqipërisë për dërgimin e këtij vendimi bankave.
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO

ANEKS

PËR DISA NDRYSHIME NË KONTRATËN TIP PËR RIBLERJEN E TITUJVE

Palët:

Banka e Shqipërisë (më poshtë "Banka"), me adresë: "Sheshi "Skënderbej", Nr. 1, Tiranë, e përfaqësuar ligjërisht në këtë kontratë nga z. _____, Drejtor i Departamentit të Operacioneve Monetare.

dhe

Banka _____ (më poshtë "banka"), _____ me adresë të selisë _____, përfaqësuar ligjërisht në këtë kontratë nga z. _____.

Bien dakord të bëjnë ndryshimet e mëposhtme në Kontratën Tip për Riblerjen e Titujve:

Neni 1

Në nenin 1 bëhen ndryshimet vijuese:

1. Pas shkronjës "c", shtohet shkronja "ç" sipas përmbajtjes së mëposhtme:

"Kreut IV të ligjit nr. 133, datë 29.4.2013 "Për sistemin e pagesave;"

2. Shkronja "f", ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

"rregullores "Për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve (AFISaR), miratuar me vendimin nr. 76, datë 18.12.2014 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, i ndryshuar;"

Neni 2

Në nenin 6, pikat 2 dhe 3 ndryshojnë përkatësisht sipas përmbajtjes së mëposhtme:

"2. Çdo formulim i kontratës që mund të sjellë paqartësi, interpretohet në përputhje me qëllimet, frymën dhe përmbajtjen e Ligjit për kontratën e riblerjes së titujve dhe Ligjit për sistemin e pagesave.

3. Për të gjitha çështjet që nuk parashikohen shprehimisht në këtë kontratë, zbatohen dispozitat e Ligjit për kontratën e riblerjes së titujve dhe Ligjit për sistemin e pagesave."

Neni 3

Në nenin 9, pas fjalës "REUTERS" shtohet fjala ", e-mail".

Neni 4

Në nenin 10 me titull "Dorëzimet dhe pagesat", bëhen ndryshimet vijuese:

1. Pas pikës 2, shtohen pikat 3 dhe 4, sipas përmbajtjes së mëposhtme:

"3. Në rastin kur njëri prej titujve të përdorur në datën e shlyerjes është zëvendësuar, gjatë kohëzgjatjes së transaksionit, me një titull tjetër, atëherë Rishitësi transferon tek Riblerësi titullin e përdorur si zëvendësues, në përputhje me parimin e dorëzimit kundrejt pagesës.

4. Në rastin kur Riblerësi ka shtuar titujt të tjerë për të kompensuar rënien e vlerës së titullit ekzistues në transaksion, atëherë në datën e shlyerjes së rënë dakord për riblerjen e titujve, Rishitësi transferon tek Riblerësi të gjithë titujt e përdorur në transaksion në përputhje me parimin e dorëzimit kundrejt pagesës..".

2. Pika 3 rinumërohet 5 dhe ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

"5. Rastet e dorëzimit me vonesë të titujve trajtohen në përputhje me rregulloren "Për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve (AFISaR)".

Neni 5

Neni 10 me titull "Zëvendësimi i titujve" rinumërohet si neni 11 dhe me titull: "Zëvendësimi i titujve dhe shtesat e kolateralit".

Neni 6

Nenet 11, 12, 13, 14, 15 dhe 16 rinumërohen përkatësisht si nenet 12, 13, 15, 16, 17 dhe 18.

Neni 7

Pas nenit 13, shtohet neni 14 me titull "Shlyerja e detyrimeve" dhe me përmbajtje si më poshtë:

"1. Pas përfundimit të afatit të ekzekutimit vullnetar të detyrimeve, titulli i përdorur si kolateral nga riblerësi bëhet pjesë e portofolit të rishitësit me vlerën e kredisë së akorduar, dhe rishitësi nis procedurat, për shitjen e titullit brenda 14 ditësh.

2. Në rast se vlera e titullit në ditën e shitjes është më e lartë se

detyrimi i riblerësit kundrejt rishitësit, diferenca i kthehet riblerësit.
3. Në rast se vlera e titullit në ditën e shitjes është më e ulët se detyrimi i riblerësit kundrejt rishitësit, riblerësi do duhet të plotësojë diferencën nëpërmjet titujve shtesë ose ekuivalentes në likuiditet.”.

Neni 8

Neni 16 ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

“Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin midis palëve nga zbatimi i kontratës, dhe që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, zgjidhen në gjykatën kompetente.”

Neni 9

Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja palët.

Kjo kontratë, pasi lexohet nga palët, nënshkruhet me vullnetin e tyre të lirë e të pavarur në 4 (katër) njësi me vlerë të barabartë ligjore, ku secila nga palët mban 2 (dy) njësi.

Për Bankën e Shqipërisë:

Z. _____

Drejtor i Departamentit t
të Operacioneve Monetare

Data: _____

Për Bankën _____

Z. _____

Data: _____



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 5, datë 24.1.2024

PËR

**MIRATIMIN E STRATEGJISË TË BANKËS SË SHQIPËRISË
“PËR KRIJIMIN E MONEDHAVE PA KURS LIGJOR, PËRKUJTIMORE DHE PËR
QËLLIME NUMIZMATIKE PËR 2024-2029”**

Në bazë të nenit 43 shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me propozim të Departamentit të Kërkimeve, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e “Strategjisë të Bankës së Shqipërisë për krijimin e monedhave pa kurs ligjor, përkujtimore dhe për qëllime numizmatike për 2024-2029”, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve të monitorojë zbatimin e Strategjisë sipas pikës së këtij vendimi dhe t’i raportojë Guvernatorit mbi ecurinë e saj.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO

STRATEGJIA E BANKËS SË SHQIPËRISË "PËR KRIJIMIN E MONEDHAVE PA KURS LIGJOR, PËRKUJTIMORE DHE PËR QËLLIME NUMIZMATIKE PËR 2024-2029"

1. TË PËRGJITHSHME

- 1.1 Strategjia e Bankës së Shqipërisë për krijimin e monedhave pa kurs ligjor, përkujtimore dhe për qëllime numizmatike për 2024-2029 (në vijim – Strategjia) përcakton misionin, vizionin, qëllimet dhe udhëzimet për zbatimin e tyre për krijimin e monedhave pa kurs ligjor, përkujtimore për qëllime numizmatike (në vijim – monedhat) në Bankën e Shqipërisë për vitet 2024-2029.
- 1.2 Strategjia parashikon drejtimit kryesore për krijimin e monedhave të Bankës së Shqipërisë në përputhje me situatën ekzistuese, traditat e monedhës shqiptare dhe përvojën ndërkombëtare, duke mbajtur parasysh diskutimin publik dhe konsultues me koleksionistët dhe tregtarët e numizmatikës shqiptare.

2. MISIONI DHE VIZIONI

- 2.1 Misioni i krijimit të monedhave do të jetë ruajtja dhe vazhdimi i traditave numizmatike shqiptare duke përkujtuar në to personalitetet, përvjetorët, objektet, ngjarjet ose fenomenet më të rëndësishme shqiptare ose ndërkombëtare, duke pasqyruar vlerat e BSH dhe shoqërisë shqiptare, përgjegjësinë e saj ndaj publikut dhe përparimit të vazhdueshëm.
- 2.2 Vizioni i krijimit të monedhave është kultivimi i marrëdhënies së BSH me publikun dhe nxitja e interesit për numizmatikën shqiptare.

3. UDHËZIMET DHE QËLLIMET E KRIJIMIT TË MONEDHAVE

- 3.1 Për të zbatuar misionin dhe vizionin e krijimit të monedhave siç është përcaktuar në Strategji, do të ndiqen proceset e mëposhtme të krijimit të monedhave:
 - a) planifikim i prodhimit të monedhave;
 - b) krijim i monedhave;
 - c) prodhimi;
 - d) marketim/ shpërndarja e monedhave.
 - e) komunikim mbi monedhat;
- 3.2 Për çdo proces të krijimit të monedhave ndiqen udhëzimet e mëposhtme:

Për procesin e planifikimit të prodhimit:

- a) Banka e Shqipërisë prodhon monedha çdo 5 vjeçar. Përgjatë kësaj periudhe parashikohet prodhimi i 1 monedhe të artë, 1 të argjenditë dhe 1 me aliazhe metalesh jo të çmuara. Në raste të veçanta mund

të konsiderohen dhe prodhime të tjera sipas nevojave të veçanta të BSH apo Shtetit. Në këto raste, vendimmarrja duhet të kryhet jo më vonë se dy vite përpara datës së ngjarjes e cila do të përkujtohet në monedhë;

- b) Monedhat e prera në ar dhe metale të çmuara të ngjashme i kushtohen përvjetorëve jubilarë me rëndësi mbarëkombëtare (p.sh. 150-vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë) dhe figurave më të rëndësishme të kombit (si për shembull Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Nënë Tereza etj.);
- c) Monedhat e prera në argjend dhe/ose në aliazhe metalesh të thjeshta i kushtohen:
 - i. përkujtimin të personaliteteve të njohura shqiptare, ngjarjeve të rëndësishme historike, kulturore, sportive, arritjeve, traditave që promovojnë vendin tonë;
 - ii. fenomeneve me interes për shoqërinë, që pasqyrojnë vlera universale, kulturore, etnografike, turistike, artistike, natyrore etj.;
- d) Vlera emërore e shënuar në monedhat përkujtimore sipas metaleve të tyre do të ndjekin përcaktimet si vijon:
 - i. 200 Lekë për monedhat e arta;
 - ii. 100 Lekë për monedhat e argjendta;
 - iii. 50 Lekë për monedhat në aliazhe metalesh të zakonshme;

Në monedhat përkujtimore, të cilat do të rishtypen sipas të njëjtave specifikime me ato ekzistuese, do të ndryshojë vetëm viti i shtypjes;

- e) Monedhat e prera për tematikat e propozuara ose të koordinuara nga organizatat ndërkombëtare që vlerësohen të rëndësishme edhe për Shqipërinë, si për shembull, Lojërat Olimpike, etj. do të përshtaten me karakteristikat e monedhave kombëtare;
- f) Në raste ekskluzive/jubilare (p.sh. 100-vjetori i themelimit të Bankës Qendrore), Banka e Shqipërisë mund të prodhojë seri monedhash që përfshin lloje të ndryshme metalesh, (p.sh. ari, argjendi dhe aliazhi i metaleve me ngjyra) që i kushtohen një teme;
- g) Banka e Shqipërisë mund të miratojë prodhimin e serive të vazhdueshme (ndër vite) me qëllim promovimin e tematikave të caktuara kombëtare, si për shembull etnografia, flora dhe fauna, arkitektura etj.

3.3 Për procesin e krijimit të monedhave:

Banka e Shqipërisë synon të krijoj monedha bashkëkohore, atraktive dhe cilësore:

- a) Për të siguruar nivel të lartë artistik të monedhave të prodhuara,

stafi i Bankës së Shqipërisë i përfshirë në procesin e prodhimit të monedhave:

- i. së bashku me kompanitë e prodhimit prestigjioze ndërkombëtare do t'i këshillojnë artistët e angazhuar në dizajnin e monedhave, me qëllim që paraqitja artistike të jetë në përputhje me teknikat më të fundit të realizimit teknik;
- ii. do të marrin pjesë në takime pune apo seminare me homologë të bankave qendrore apo kompani prodhimi prestigjioze ndërkombëtare, ku paraqiten risitë dhe përjasjet më të reja në fushën e prodhimit të monedhave.

3.4 Për procesin e prodhimit:

- a) Tirazhi i prodhimit të jetë i drejtë në bazë të të dhënave të shitjeve në tre vitet e fundit nga kompani prestigjioze për prodhimin e monedhave;
- b) Qëllimi është që tirazhet e prodhimit të mos krijojnë stoke afatgjata. Objektiv i është që çdo prerje (tirazhi i saj total) të shitet brenda një periudhe 10-vjeçare. Planifikimi i tirazheve bëhet duke iu referuar përcaktimeve të mëposhtme:
 - i. për monedha ari - deri në 500 copë;
 - ii. për monedha argjendi – 500 deri në 1000 copë;
 - iii. për monedhat prej metali me aliazhe të thjeshta – 500 deri në 1000 copë.
- c) Tirazhet e mësipërme do të ndahen në këto fonde:
 - i. Fond i Paprekshëm – 5 copë;
 - ii. Fond Numizmatik për Muzeun – 4 copë;
 - iii. Fond për Dhurata – 100 copë;
 - iv. Fond për Shitje – diferenca.
- d) Monedhat do të prodhohen në cilësitë e mëposhtme:
 - i. *Provë-Proof* – Këto lloj monedhash janë të standardeve më të larta të prodhimit dhe kualitetit për sa u përket monedhave përkujtimore;
 - ii. *BU – Brilliant Uncirculated* - monedha me sipërfaqe dhe relief po aq të shkëlqyeshëm, por e një cilësie më të ulët që zakonisht përdoret për monedhat me aliazhe metalesh të thjeshta.
- e) Monedhat përkujtimore të Bankës së Shqipërisë duhet të mbajnë detyrimisht këto legjenda:
 - i. Në anën e përparme, vlerën emërore të shprehur në LEK dhe tematikën;
 - ii. Në anën e pasme, shkrimet "Shqipëri", "Albania" dhe vitin e shtypjes.
- f) Monedhat përkujtimore prej ari dhe argjendi paketohen në një kapsulë dhe një kuti ambalazhimi të personalizuar. Monedhat prej

metali me aliazhe të thjeshta do të tregtohen të paketuara si më lart por me një kuti apo zarf me kosto më të ulët ose në paketime speciale, si kartolina me informacion për tematikën e paraqitur në monedhë. Ambalazhet e monedhave duhet të mbartin të paktën legjendat "Banka e Shqipërisë", "Bank of Albania".

- g) Në rastet e prodhimit të serive të monedhave me të njëjtën tematikë, një pjesë e tirazhit të shtypur do të kërkohen të dorëzohen nga prodhuesi, të paketuara si sete, në kuti speciale, me qëllim tregtimi dhe dhurimi protokollar.
- h) Të gjitha kutitë e monedhave përkujtimore të BSH duhet të jenë të pajisura që në prodhim me certifikata që specifikojnë: emetuesin, prodhuesin, tematikën, specifikimet teknike, artisti/en, vlerën e shënuar mbi monedhë. Në çdo rast, certifikatat duhet të mbajnë nënshkrimin e Guvernatorit poshtë specifikimeve teknike.

3.5 Për procesin e marketimit/ shpërndarjes së monedhave:

- a) sigurimi i një shpërndarjeje/marketimi eficient;
- b) përmirësimi i cilësisë, transparencës dhe shërbimit dhe marrëdhënieve me klientët.

3.6 Për procesin e komunikimit mbi monedhave:

- a) të promovohet Banka e Shqipërisë dhe roli i saj në mbështetjen e traditave numizmatike shqiptare dhe ato të shoqërisë;
- b) të nxitet interesi publik në koleksionimin e monedhave shqiptare.

4. MASAT E ZBATIMIT TË STRATEGJISË

Masat, treguesit dhe afatet kohore për zbatimin e Strategjisë do të jenë si më poshtë:

Objektivi	Qëllimi	Masat	Treguesit	Data e zbatimit
Planifikimi i prodhimit përkujtimor	Të përfaqësohen në monedhë tematikat më të rëndësishme të vlerave kombëtare historike, etnografike, kulturore, sportive, natyrore kombëtare e ndërkombëtare	Të përfshihen institucionet kryesore të dijes, kulturës, artit, koleksionimit në planifikimin e tematikave të monedhës. Konsultimi me ekspertë të institucioneve më sipër	Dërgimi i korrespondencës zyrtare pranë institucioneve për sugjerime për tematikat e monedhave përkujtimore 2030	Deri më 31 mars 2024
			Dërgimi i korrespondencës zyrtare për institucionet për përcaktimin e ekspertëve në fushat e përmendura.	Deri më 31 mars 2024
			Hartimi i një plani të brendshëm sugjerues mbi tematikat që i prezantohen paraprakisht Administratorëve	Deri më 31 mars 2024
			Ngritja e Grupit të Punës dhe organizimi i të paktën një mbledhje me ekspertët e institucioneve dhe BSH-së. Sugjerimet mbi tematikat	Deri më 30 maj 2024
		Hartimi i planit 5 vjeçar të prodhimit përkujtimor	Miratimi paraprak pra në parim nga Administratori i linjës	Deri më 31 gusht 2024
Krijimi i monedhave	Të krijohen monedha bashkëkohore, atraktive dhe cilësore	Konsultime mbi teknikat e ditës të prodhimit pa kurs ligjor dhe buxhetet e nevojshme për realizimin e tyre	Të paktën tri korrespondenca/ mbledhje online me kompani prodhuese me të cilat BSH ka lidhur kontrata për prodhimin përkujtimor.	Deri më 30 shtator 2024
		Draftimi i projekt buxhetit bazuar në teknikat e prodhimit, numrit të monedhave si dhe kostos së metaleve e prodhimit të tyre në tërësi (ambalazhim, dizajn, shtypje, doganë etj)	Propozimi në projektbuxhetin e njësisë për vitin 2025	Deri më 30 shtator 2024
	Vendimmarrja mbi specifikimet teknike dhe tematikat	Draftimi i projektvendimit të parë mbi monedhat përkujtimore të BSH për 5-vjeçarin	Propozimi i projektit për shqyrtim nga Këshilli Mbikëqyrës	Deri më 30 nëntor 2024
	Organizimi i konkursit të dizajnit	Reklamimi dhe shpallja e konkursit	Reklamimi i konkursit përmes prezantimeve, ngjarjeve të dedikuara në fakultetet e arteve të vendit dhe në trevat shqiptolëse (Kosovë, Maqedonia e Veriut). Shpallja e konkursit. Organizmi i ngjarjeve të dedikuara si Netët e Muzeut, Dita Ndërkombëtare e Muzeve etj. Shpallja e konkursit në webin e BSH-së dhe rrjetet e saj sociale. Dërgimi pranë artistëve të afirmuar dhe fakulteteve të arteve të bukura brenda dhe jashtë vendit (analogji me çmimin e Guvernatorit për Diplomën më të mirë)	Deri më 31 mars 2025
	Vendimmarrja mbi konfigurimin e monedhave	Draftimi i projektvendimit për KM	Propozimi i projektit për shqyrtim nga Këshilli Mbikëqyrës	Deri më 30 qershor 2025

Prodhimi	Zgjedhja e kompanive prestigjioze për prodhimin e monedhave	Draftimi i dokumenteve të prokurimit në cilësinë dhe kohën e duhur	Dërgimi i kërkesës për hapjen e procedurës së prokurimit pranë DA	Deri më 15 korrik 2025
	Ndjekja e procesit të prokurimit dhe prodhimit	Mbajtja e kontakteve me DA, DE dhe kompaninë prodhuese	Dërgimi i korrespondencës mbi studimin e tregut, procesin e prokurimit dhe nënshkrimin e kontratës Ndjekja e kontratës deri në mbërritjen e mallit, miratimi i procedurës për kontrollin sasior dhe cilësorë	Sipas procesit/gjatë vitit 2025 Sipas procesit/gjatë vitit 2025
Marketimi i monedhës përkujtimore	Sigurimi i një shpërndarjeje/ marketimi eficient dhe transparent	Draftimi i kostos dhe përcaktimi i çmimit	Paraqitja pranë DSPKF dhe DE, regjistrimi në arkat e BSH, tërheqja nga AS	Brenda 1 muaji pasi sasia totale e monedhave është pranuar nga BSH
			Miratimi i çmimit të shitjes	Brenda 1 muaji pasi sasia totale e monedhave është pranuar nga BSH
		Marketimi në kohë dhe në kanale të ndryshme komunikimi	Fotografimi, krijimi i videove, dërgimi i korrespondencës zyrtare pranë entiteteve shtetërore apo private që dhurojnë, shesin artikuj të tillë	Brenda 3 muajsh pasi sasia totale e monedhave është pranuar nga BSH
	Përmirësimi i cilësisë së shërbimit dhe marrëdhënieve me klientët.	Rishikim dhe përmirësim i procesit të shërbimit ndaj klientëve (dërgim i e-maileve pranë klientëve dhe medimeve ndërkombëtare të numizmatikës, si për shembull Conis and Mint News etj. me qëllim reklamimin e monedhës përkujtimore të re)	Dërgimi i korrespondencave	Brenda 3 muajsh pasi sasia totale e monedhave është pranuar nga BSH
		Realizimi i vrojtimeve për matjen e kënaqësisë së klientëve dhe problematikave të monedhave përfshirë (tematikat, cilësinë e prodhimit, sasinë e monedhave për çdo metal, etj.)	Vrojtimet organizohen sipas metodologjive statistikore dhe synojnë një shkallë përgjigje të paktën 70%	1 herë në 3 vjet
		Shqyrtohet mundësia për marketing dhe tregtimin e monedhave numizmatike me shumicë dhe përmes dyqanit virtual të Muzeut	Janë shqyrtuar mundësitë dhe sipas mundësisë janë gati për implementim.	Brenda vitit 2029

Komunikimi mbi monedhat	Promovimi i BSH dhe aktivitetit numizmatik përmes monedhave përkujtimore. Nxitja e interesit të publikut për koleksionimin e monedhave dhe kartëmonedhave shqiptare me dhe pa kurs ligjor	Përgatitja e prezantimeve dhe ekspozitave lokale të monedhave të BSH duke krijuar ura komunikimi me publikun dhe grupe të ndryshme interesi	Të publikohet informacion për publikun e gjerë në rrjetet sociale që prek të paktën 1000 klientë	Gjatë 5-vjeçarit
			Video 2 D dhe 3 D për çdo monedhë të re të prodhuar në anglisht.	Përgjatë 5 viteve
			Përgatitja e një e-broshure për t'u shfaqur në webin e BSH me informacion mbi monedhat e reja, në shqip dhe anglisht	Brenda 3 muajsh pasi sasia totale e monedhave është pranuar nga BSH



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 6, datë 24.1.2024

**PËR
MIRATIMIN E "STRATEGJISË SË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR EDUKIMIN
DHE PËRFSHIRJEN FINANCIARE, 2024-2026"**

Në bazë të nenit 43 shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; me propozim të Departamentit të Kërkimeve, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e "Strategjisë së Bankës së Shqipërisë për edukimin dhe përfshirjen financiare, 2024-2026", bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Departamentet e Bankës së Shqipërisë, të cilat kanë detyrime që rrjedhin nga Strategjia për edukimin dhe përfshirjen financiare 2024-2026, informojnë Administratorët përkatës dhe Departamentin e Kërkimeve për realizimin e tyre.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve të monitorojë zbatimin e "Strategjisë së Bankës së Shqipërisë për edukimin dhe përfshirjen financiare, 2024-2026" dhe t'i raportojë Guvernatorit mbi ecurinë e tij.
4. Ngarkohen Departamenti i Kërkimeve, Departamenti i Politikës Monetare, Departamenti i Stabilitetit Financiar, Departamenti i Mbikëqyrjes, Departamenti i Operacioneve Monetare, Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Departamenti i Emisionit dhe Departamenti i Teknologjisë dhe Informacionit me zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO

STRATEGJIA E BANKËS SË SHQIPËRISË PËR EDUKIMIN DHE PËRFSHIRJEN FINANCIARE, 2024-2026¹

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Banka e Shqipërisë (BSH) me asistencën teknike të Bankës Botërore, ka hartuar Strategjinë e Bankës së Shqipërisë për Edukimin dhe Përfshirjen Financiare (SBSHEPF), një dokument i parë i koordinuar institucionalisht për të promovuar edukimin financiar si një nxitës kyç i përfshirjes financiare, mirëqenies dhe qëndrueshmërisë për të gjithë.
2. SBSHEPF është hartuar duke u mbështetur në punën dhe objektivat e Bankës së Shqipërisë, në zhvillim të përpjekjeve ekzistuese shumëvjeçare në fushën e edukimit financiar, si dhe në ato të institucioneve partnere publike dhe private, të pasqyruara në Hartën e Nismave të Edukimit Financiar në Shqipëri (2023). Strategjia është mbështetur nga rezultatet dhe analizat e Vrojtimit për Matjen e Kulturës dhe Përfshirjes Financiare të kryer në vitin 2019 nga Banka e Shqipërisë. Edukimi financiar ka qenë në vëmendjen e BSH-së prej mbi 15 vjetësh. Ajo ka një eksperiencë të gjatë dhe të suksesshme në fushën e edukimit dhe të përfshirjes financiare, të bazuar në praktikat më të mira botërore. SBSHEPF ofron një kornizë për të realizuar objektivat e BSH-së për edukimin dhe përfshirjen financiare.
3. SBSHEPF bazohet në standardet, udhëzimet dhe parimet ndërkombëtare të hartuara nga OECD dhe të miratuara nga G20. Roli i edukimit financiar në përmirësimin e mirëqenies financiare të individëve dhe sigurimin e stabilitetit dhe funksionimit efektiv të tregjeve financiare është njohur dhe pranuar gjerësisht. Një sërë organizmash ndërkombëtarë rekomandojnë adresimin e rritjes së kulturës financiare nga institucionet publike përmes hartimit dhe zbatimit të strategjive kombëtare të edukimit financiar².

¹ Kjo strategji është kurorëzim i punës dhe përpjekjeve shumëvjeçare të Bankës së Shqipërisë (BSH) dhe partnerëve të tjerë, në fushën e edukimit dhe përfshirjes financiare të popullsisë shqiptare. Autorët dëshirojnë të falënderojnë Grupin e Bankës Botërore për ndihmën dhe kontributin e dhënë në hartimin e këtij dokumenti, si dhe Sekretariatit Shtetëror të Zvicrës për Çështjet Ekonomike (SECO) për mbështetjen financiare.

² G20/OECD ka miratuar agjendën e edukimit financiar duke prezantuar një sërë parimesh të nivelit të lartë: Përfshirja Financiare Novatore (2010); Mbrojtja Financiare e Konsumatorit (2011); Strategjitë Kombëtare për Edukimin Financiar (2012); Rekomandimi i Këshillit të OECD për Kulturën Financiare, OECD/LEGAL/0461; dhe Parimet e nivelit të lartë të G20 për Përfshirjen Financiare Digjitale (2021).

4. **Banka e Shqipërisë e ka renditur edukimin e publikut ndër objektivat e saj strategjike që nga viti 2003³, me fokus kryesisht njohjen e institucionit të bankës qendrore dhe rritjen e transparencës së saj në publik. Mbi bazën e kësaj eksperience, por edhe në përputhje edhe me zhvillimet globale në këtë fushë, natyrshëm u tranzitua drejt edukimit financiar të publikut. Në strategjitë afatmesme të Bankës së Shqipërisë, duke filluar nga ajo për periudhën 2013-2015 e në vijim, rritja e kulturës financiare në vend vendoset si objektiv strategjik i Bankës së Shqipërisë.**
5. **Nga viti 2011 me frekuencë një herë në 4 vjet, BSH kryen vrojtimin kombëtar për matjen e nivelit të kulturës dhe përfshirjes financiare të popullatës së rritur në Shqipëri, bazuar në metodologjinë e OECD/INFE. Ky vrojtim vlerëson njohuritë, sjelljet dhe qëndrimet financiare dhe të dhënat e tij përdoren për të informuar vendimmarrjen dhe politikën e edukimit. Rezultatet e vrojtimin të vitit 2019, tregojnë që individët në Shqipëri zotërojnë vetëm 53% të njohurive, sjelljeve dhe qëndrimeve të duhura financiare, krahasuar me mesataren globale prej 63%. Kjo reflektohet edhe në një nivel të ulët të përfshirjes financiare, si në aspektin e aksesit ashtu edhe të përdorimit.**
6. **Mirëqenia financiare, e konsideruar si objektivi përfundimtar i edukimit financiar, është e ulët (vlerësuar 7.7 nga 20), çka tregon se individët në Shqipëri janë përgjithësisht të pasigurt për financat e tyre. Indeksi mesatar global është 9.5 dhe mesatarja e OECD-së është 9.9 për 2019. Një rezultat nën mesataren tregon se mirëqenia financiare e individëve në Shqipëri është e ulët, duke i bërë të ndihen të pasigurt për të ardhmen dhe të kenë më pak besim që do të jenë në gjendje të absorbojnë goditjet financiare.**
7. **Misioni i SBSHEPF është të sigurojë që individët në Shqipëri të fitojnë njohuritë, të zotërojnë aftësitë, të mbajnë qëndrimet dhe të zhvillojnë sjelljet e duhura, të sakta dhe të zbatueshme që u mundësojnë atyre të marrin vendime financiare të mirinformuara, me synim final përmirësimin e mirëqenies dhe qëndrueshmërisë së tyre financiare.**
8. **Objektivat kryesorë të SBSHEPF janë: i) Miradministrimi i financave personale dhe huamarrja e shëndetshme; ii) Planifikimi dhe kursimi për të ardhmen; iii) Parandalimi dhe mbrojtja e konsumatorit.**
9. **Për t'i realizuar këta objektiva, Banka e Shqipërisë do të bazohet në këto parime strategjike: a) Iniciativa me shtrirje të madhe dhe për një publik të gjerë; b) Rritja e përdorimit të mjeteve dhe burimeve të paanshme të informacionit financiar, drejtuar kryesisht segmenteve**

³ Dokumenti "Plan zhvillimi institucional për periudhën afatmesme, 2003-2005", Banka e Shqipërisë, 2003.

vulnerabël të popullsisë; c) Ofrimit të udhëzimeve dhe këshillimit të shënjestruar dhe me cilësi; d) Kërkimi i sinergjive në organizimin e aktiviteteve dhe programeve të përbashkëta me institucione e tjera; e) Përmirësimi i monitorimit dhe vlerësimit.

1. HYRJE

10. **Strategjia e Bankës së Shqipërisë për Edukimin dhe Përfshirjen Financiare (SBSHEPF) 2024-2026 është hartuar në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe është një dokument që zyrtarizon përpjekjet e Bankës së Shqipërisë për të promovuar edukimin financiar si një e mirë publike për të gjithë, për të nxitur më tej përfshirjen financiare, mbrojtjen e konsumatorëve dhe rritjen e mirëqenies financiare të individëve dhe të qëndrueshmërisë së sistemit financiar në tërësi.**
11. **Roli i edukimit financiar në përmirësimin e mirëqenies financiare të individëve dhe sigurimin e stabilitetit dhe funksionimit efektiv të tregjeve financiare është njohur dhe pranuar gjerësisht. G20/OECD ka miratuar agjendën e edukimit financiar duke prezantuar një sërë parimesh të nivelit të lartë: Përfshirja Financiare Novatore (2010); Mbrojtja Financiare e Konsumatorit (2011); Strategjitë Kombëtare për Edukimin Financiar (2012); Rekomandimi i Këshillit të OECD për Kulturën Financiare, OECD/LEGAL/0461; dhe Parimet e nivelit të lartë të G20 për Përfshirjen Financiare Digjitale (2021).**
12. **Edukimi i publikut është renditur si një ndër objektivat strategjike të Bankës së Shqipërisë që nga viti 2003⁴, me fokus kryesisht njohjen e rolit të bankës qendrore, objektivit kryesor të stabilitetit të çmimeve, të objektivave të tjerë dytësorë, si dhe të funksioneve të saj. Në Strategjinë afatmesme të Bankës së Shqipërisë për periudhën 2013-2015⁵, rritja e kulturës financiare në vend, kryesisht tek brezat e rinj përcaktohet si objektiv strategjik i Bankës së Shqipërisë në funksion të stabilitetit të çmimeve dhe të stabilitetit financiar.**

⁴ Dokumenti "Plan zhvillimi institucional për periudhën afatmesme, 2003-2005", Banka e Shqipërisë, 2002.

⁵ Strategjitë afatmesme të Bankës së Shqipërisë për periudhat 2013-2015; 2016-2018; 2019-2021, 2022-2024; 2023-2025, Banka e Shqipërisë.

Në këtë Strategji, termat “Edukim Financiar”, “Kulturë Financiare” dhe “Përfshirje financiare” janë përdorur sipas përkufizimeve të OECD:


- **Edukimi financiar** është një mjet për rritjen e kulturës financiare të konsumatorëve. Sipas OECD-së*, edukimi financiar është procesi me anë të të cilit konsumatorët financiarë dhe investitorët përmirësojnë të kuptuarit e produkteve dhe koncepteve financiare dhe, nëpërmjet informacionit, udhëzimeve dhe këshillave objektive, zhvillojnë aftësi dhe vetëbesim për t'u bërë më të ndërgjegjshëm për rreziqet dhe mundësitë financiare, të bëjnë zgjedhje të informuara, të dinë se ku të drejtohen për ndihmë dhe të ndërmarrin veprime të tjera efektive për të përmirësuar mirëqenien e tyre financiare.
- **Kultura financiare** përfaqëson një kombinim të ndërgjegjësimit, njohurive, aftësive, qëndrimit dhe sjelljes së nevojshme për të marrë vendime financiare të shëndosha dhe me synim fundor rritjen e mirëqenies financiare individuale (OECD/INFE, 2015).
- **Përfshirja financiare** është procesi i promovimit të aksesit të përballueshëm, në kohë dhe adekuat ndaj produkteve dhe shërbimeve financiare të rregulluara dhe zgjerimit të përdorimit të tyre nga të gjitha segmentet e shoqërisë përmes zbatimit të qasjeve të përshtatura, ekzistuese dhe inovative duke përfshirë ndërgjegjësimin financiar dhe edukimin, me synimin për të promovuar mirëqenien financiare si dhe përfshirjen ekonomike dhe sociale.

Termet “edukim financiar” dhe “kulturë” shpesh përdoren në mënyrë të ndërsjellë, por përfaqësojnë koncepte shumë të dallueshme. Shkurtimisht, edukimi financiar synon të rrisë kulturën financiare të konsumatorëve, gjë që u mundëson individëve të bëhen më të aftë financiarisht (rezultat i përmirësimit të kulturës financiare) kur zbatojnë njohuritë e tyre në praktikë.

* (OECD 2005).

13. SBSHEPF është dizenuar për të garantuar që individët në Shqipëri të kenë mundësi të zhvillojnë njohuri e kapacitete të mjaftueshme, të sakta e të aplikueshme dhe të adaptojnë sjellje dhe qëndrime që i bëjnë ata të ndërmarrin veprime ekonomike e financiare të mirinformuara më qëllim përmirësimin e mirëqenies ekonomike e financiare.

Figura 2: Teoria e ndryshimit për edukimin financiar



14. Kjo Strategji vjen si një domosdoshmëri për të rritur më tej kulturën financiare dhe përdorimin e shërbimeve financiare të rregulluara në kushtet e sofistikimit të sektorit financiar dhe të rreziqeve të reja për konsumatorin. Edukimi financiar mund të adresojë barrierat e kërkesës, të tilla si perceptimi se nuk i përmbush kushtet për të përfituar një produkt financiar, kanë kosto të lartë, njohuritë e pakta mbi produktet financiare, rreziku që ato mbartin etj. Me rritjen e kulturës financiare, individët familjarizohen me produktet financiare, mundësitë që ofrojnë ato në terma të pagesave, kursimeve dhe investimeve, si dhe fillojnë t'i aksesojnë dhe t'i përdorin ato. Nga ana tjetër, rritja e kërkesës mund t'i nxisë ofruesit e produkteve dhe shërbimeve financiare të zhvillojnë produkte më të përshtatshme financiare dhe për të përmbushur kërkesën në rritje për to. Njëkohësisht, individët e edukuar financiarisht mund të mbrohen më mirë ndaj borxhit të tepërt, rreziqeve që mbartin produktet dhe shërbimet financiare, mbrojtjes së të dhënave të tyre personale, praktikave mashtruese etj. Së fundi, me rritjen e shërbimeve digjitale dhe inovative, lehtësirat që ofrojnë ato, edukimi financiar në këtë drejtim do të luajë një rol kyç në aftësimin e konsumatorëve edhe për përdorimin e sigurt dhe përvetësimin e shërbimeve financiare digjitale.
15. Përmes rritjes së kulturës financiare, SBSHEPF do të synojë të ndihmojë në përmirësimin e transmetimit të politikës monetare. Individët me nivel të lartë të kulturës financiare marrin vendime financiare më të mira dhe në kohë, reagojnë më shpejt dhe në mënyrën e duhur ndaj ndryshimeve të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, duke mundësuar kështu një funksionim më efikas të kanaleve të transmetimit monetar.
16. Në këtë kuadër, BSH, në bashkëpunim me aktorë të tjerë të sektorit financiar, ka udhëhequr përpjekjet për edukimin financiar në Shqipëri. Nga viti 2006, BSH e ka trajtuar çështjen e edukimit financiar si një nga prioritetet e saj, duke i konsideruar ndërgjegjësimin dhe promovimin e edukimit financiar si një të mirë publike. Nga ana tjetër, aktorë të ndryshëm kanë zbatuar një gamë të gjerë aktiviteteve për edukimin financiar. Në vitin 2018,

disa nga aktorët e tjerë më aktivë në edukimin financiar krijuan Rrjetin Shqiptar të Edukimit Financiar (ANFE) për të koordinuar veprimtarinë e tyre në këtë fushë. Banka e Shqipërisë ka mbajtur një lidhje të vazhdueshme me këtë rrjet dhe është përpjekur të informojë punën e tyre dhe të orientojë dhe të bashkëpunojë duke lehtësuar (kur ka qenë e mundur) aktivitetet e rrjetit. Përveç iniciativave individuale, mes BSH dhe institucioneve homologe është ngritur një marrëdhënie partneriteti edhe në lëmin e edukimit financiar, me organizimin e një sërë aktivitetesh të përbashkëta. Një traditë e mirë bashkëpunimi mes BSH, AAB, ASD dhe JAA është ndërtuar gjatë zhvillimit të aktiviteteve të Javës së Parasë.

17. **Përpjekjet për të promovuar edukimin financiar në Shqipëri shkojnë paralelisht me disa reforma madhore në sektorin financiar, të cilat synojnë përmirësimin e përfshirjes financiare, eficiencës dhe shumëllojshmërisë së shërbimeve financiare në vend.** SBSHEPF nuk synon t'i mbivendoset ose të anashkalojë analizat dhe strategjitë ekzistuese, por i plotëson dhe referon këto dokumente thelbësore dhe ofron një kornizë për të realizuar objektivat e edukimit dhe përfshirjes financiare. Ajo është në një linjë edhe me objektivat specifike të Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël (SKPVV)⁶.
18. **SBSHEPF është hartuar duke u mbështetur në rezultatet e Vrojtimit për Matjen e Kulturës dhe Përfshirjes Financiare të kryer në vitin 2019, në Hartën e Nismave të Edukimit Financiar në Shqipëri të kryer në vitin 2023, si dhe mbështetur në vrojtime të tjera të kryera nga BSH, si p.sh. Vrojtimi i Pasurisë së Familjeve Shqiptare⁷.** Rezultatet e vrojtimeve të ardhshme do të shërbejnë për të matur dhe monitoruar impaktin e aktiviteteve edukuese në periudhën e referencës dhe për të orientuar strategjinë në të ardhmen.
19. **Qëllimi i SBSHEPF është të ofrojë një qasje koherente, të koordinuar institucionalisht dhe të fokusuar drejt objektivit për hartimin dhe ofrimin e aktiviteteve të edukimit financiar.** Më konkretisht, SBSHEPF synon: (i) të mbështesë vizionin, misionin dhe objektivat për edukimin financiar; (ii) të analizojë gjendjen aktuale të aftësive financiare në Shqipëri, duke përfshirë programet kryesore të edukimit financiar, për të ndërmarrë veprime të informuara në të ardhmen; (iii) të identifikojë segmentet e popullatës dhe veprimet që do të kenë prioritet; (iv) të ofrojë udhëzime për krijimin dhe funksionimin e një strukture koordinuese të edukimit financiar, duke përfshirë sistemet e monitorimit, vlerësimit dhe raportimit; dhe (v) të përfshijë burimet njerëzore me ekspertizë në fushat kryesore

⁶ Dokument i miratuar nga Komiteti Kombëtar i Sistemit të Pagesave.

⁷ Për një përmbledhje mbi rezultatet e vrojtimit të raundit të parë, ju lutem referojuni, Dushku, E., Çami, O., (2022), "Albanian Household Wealth Survey-results from the first wave", Bank of Albania Working Paper, 02 (89) 2022).

të bankingut qendror: politikës monetare, mbikëqyrjes bankare, sistemeve të pagesave, stabilitetit financiar, kërkimit.

20. Materiali është organizuar si më poshtë. Pjesa e 2 vlerëson gjendjen aktuale të kulturës dhe përfshirjes financiare të Shqipërisë. Pjesa e 3 paraqet fillesat dhe fokusin aktual të edukimit financiar, boshllëqet dhe hapësirat për përmirësim. Pjesa e 4 shpjegon qëllimin, misionin dhe vizionin e SBSHEPF, si dhe thekson objektivat kryesorë dhe ata strategjikë ku do të fokusohet veprimtaria. Pjesa e 5 ofron një panoramë të kuadrit për veprim, kornizës institucionale dhe buxhetit të nevojshëm për zbatimin e strategjisë. Pjesa e 6 rendit treguesit kryesorë të performancës për monitorimin dhe vlerësimin e impaktit të SBSHEPF. Pjesa e 7 i detajon objektivat strategjikë, si dhe paraqet planin e veprimit 2024-2026, për zbatimin e SBSHEPF.

2. KONTEKSTI I VENDIT DHE TIPARET E TREGUT

GJENDJA E KULTURËS DHE PËRFSHIRJES FINANCIARE

21. **Vrojtimet dhe analizat e Bankës së Shqipërisë tregojnë se kultura dhe përfshirja financiare nuk janë në nivelet e dëshiruara.** Vrojtimi i Bankës së Shqipërisë për Matjen e Kulturës dhe Përfshirjes Financiare të kryer në vitin 2019 tregon se indeksi i kulturës financiare - apo totali i njohurive, sjelljeve dhe qëndrimeve të përshtatshme financiare - është në nivelin e 11.2 nga 21 që është vlera maksimale e këtij indeksi. Gjithashtu, vlera e këtij indeksi qëndron më poshtë se mesatarja e indeksit për të gjithë vendet të përfshirë në vrojtimin e 2019, (12.7) dhe e vendeve të OECD-së (13.0)⁸. Ky nivel i ulët i kulturës financiare të të rriturve në Shqipëri reflektohet në një nivel të ulët të përfshirjes financiare, si për sa i përket njohjes, ashtu edhe përdorimit të produkteve dhe shërbimeve financiare.
22. **Të dhënat nga Vrojtimi i BSH-së për Matjen e Kulturës dhe Përfshirjes Financiare në 2019 në Shqipëri, krahasuar me vendet e tjera të përfshira në vrojtimin e OECD-së⁹, po të njëjtin vit tregojnë që si njohja dhe përdorimi i produkteve financiare në Shqipëri është poshtë mesatares së vendeve që morën pjesë në vrojtimin e 2019.** Në Shqipëri vetëm 54% e individëve i njohin produktet financiare, më poshtë se mesatarja globale (83%) dhe e vendeve të OECD-së (86%). Në lidhje me përdorimin e produkteve financiare vërehet se vetëm 46% e individëve në botë dhe 41% e individëve në vendet e OECD-së kanë zgjedhur të përdorin një produkt financiar gjatë vitit të fundit,

⁸ Revista Ekonomike 6M-2, 2021, Banka e Shqipërisë, "Fakte mbi nivelin e kulturës dhe përfshirjes financiare në Shqipëri", Elona Dushku, 2021.

⁹ OECD/INFE 2020, International Survey of Adult Financial Literacy.

tregues që shfaqet mjaft heterogjen midis vendeve. Në Shqipëri, ky tregues është 37%, poshtë mesatares globale dhe të vendeve të OECD-së.

23. Gjithashtu të dhënat e vrojtimit tregojnë se produktet e pagesave (llogaritë rrjedhëse, kartat me parapagesë, shërbimet e pagesave nëpërmjet celularit) janë produktet financiare që zotërohen më shumë, nga 29% të individëve. Produktet e dyta financiare më të zotëruara në Shqipëri janë produktet e kursimit (22%), të ndjekura nga produktet e kreditit (13%) dhe produktet e sigurimit (9%). Niveli i zotërimit të këtyre produkteve është dy deri në katër herë më i ulët se mesatarja e OECD-së¹⁰.

NDËRGJEGJËSIMI FINANCIAR

24. Njohja e produkteve, shërbimeve dhe koncepteve të ndryshme financiare është thelbësore për të mundësuar më tej aksesin dhe përfshirjen financiare. Njohja bazike e produkteve dhe shërbimeve financiare është një parakusht për të kuptuar dhe përzgjedhur mjetet e përshtatshme financiare, për të menaxhuar paratë dhe për të shmangur rreziqet. Nga vrojtimet rezulton se një pjesë e konsiderueshme e shqiptarëve nuk i njohin produktet dhe shërbimet financiare të disponueshme. Shpesh kjo ndodh për shkak të njohurive financiare, mungesës së ekspozimit dhe aksesit të ulët në institucione apo shërbime të ndryshme financiare.
25. **Indeksi i njohurive financiare në vitin 2019 shënoi vlerën e 3.7 (nga 7 që është vlera maksimale), më i ulët se indeksi mesatar global (4.4). Vetëm 29% e individëve mund t'i përgjigjen saktë 5 nga 7 pyetjeve mbi njohuritë financiare, që është rezultati minimal i synuar për njohuritë financiare. Shqiptarët shpesh hasin vështirësi në kuptimin e vlerës në kohë të parasë dhe të normës së përbërë të interesit, përkatësisht vetëm 26% dhe 11% e individëve iu përgjigjen saktë këtyre pyetjeve, ose më pak se gjysma e niveleve globale (përkatësisht 65% dhe 11%).**
26. **Vetëm 54% e shqiptarëve njohin të paktën pesë produkte financiare, krahasuar me 83% të individëve në nivel global dhe 86% në vendet e OECD-së. Më pak se 40% e individëve kanë përdorur një produkt financiar vitin e fundit, ndërsa në nivel global ky tregues është më pak se 50%. Një e treta (ose 33%) e shqiptarëve i drejtohen familjes dhe miqve të ngushtë për të marrë borxh dhe për të kursyer para, nivel ky më i lartë se mesatarja globale dhe se mesatarja e vendeve të OECD-së.**

¹⁰ Në botë, mjetet e pagesës gjejnë një përdorim shumë të gjerë nga 70% e individëve në nivel global, në 81% e individëve në vendet e OECD-së. Globalisht, 50% e individëve zotërojnë produkte kursimi, 44% kanë produkte krediti dhe 37% kanë produkte financiare sigurimesh.

27. **Indeksi i sjelljes financiare të të rriturve në Shqipëri është 4.3 nga 9, çka tregon se individët shfaqin më pak se gjysmën (47%) e sjelljeve financiare të kujdeshme.** Për më tepër, të dhënat tregojnë se vetëm një e katërta e individëve kanë arritur rezultatin minimal të synuar për sjelljen financiare (6 nga 9), krahasuar me mesataren globale prej 49%.
28. **Shqipëria shënon rezultate pak më të larta se mesatarja globale për sa i përket indeksit të qëndrimeve financiare (3.2 nga 5).** Ky tregues dëshmon se shqiptarët shfaqin 64% të qëndrimeve kyçe afatgjata ndaj parasë, veçanërisht sa i përket planifikimit për të ardhmen dhe buxhetimit. Më shumë se gjysma e individëve demonstronë nivelin minimal të synuar për qëndrimin financiar (3 nga 5), duke shfaqur një qëndrim pozitiv ndaj planifikimit financiar, kursimit të të ardhurave dhe mirëqenies financiare.

PLANIFIKIMI FINANCIAR DHE MENAXHIMI I PARAVE

29. **Buxhetimi është një strategji thelbësore për menaxhimin e financave me qëllim përballimin e shpenzimeve dhe arritjen e qëllimeve financiare.** Pak më shumë se gjysma e shqiptarëve të anketuar raportojnë se planifikojnë gjithmonë se si do t'i shpenzojnë paratë dhe vetëm 42% e ndjekin gjithmonë planin. Një përqindje më e vogël e të rriturve mbajnë shënim shpenzimet e tyre të përditshme (26%). Individët që janë klientë bankarë, kanë më shumë gjasa t'i gjurmojnë saktë veprimet e tyre financiare, sesa jo-klientët. Të rriturit që i përmbahen shpesh planit të tyre ose që gjurmojnë shpenzimet e tyre të përditshme priren të kenë indeks më të lartë të kulturës financiare.
30. **Pothuajse të gjithë shqiptarët raportojnë se kanë një objektiv financiar (94%).** Shumica e të rriturve (91%) përmendin planifikimin për të ardhmen e fëmijëve, si objektivin e tyre kryesor. Objektivat e tjera përfshijnë ndërtimin ose përmirësimin e kushteve të banesës (38%), fillimin e një biznesi (16%), ose investimin në një fermë (15%).
31. **Mirëqenia financiare, e konsideruar si objektivi përfundimtar i edukimit financiar, qëndron në një nivel të ulët, me një rezultat të vlerësuar prej 7.7 nga 20, çka tregon se individët në Shqipëri janë përgjithësisht të pasigurt për financat e tyre.** Indeksi mesatar global është 9.5 dhe mesatarja e OECD-së është 9.9. Një rezultat nën mesataren tregon se gjendja financiare e individëve të anketuar i kufizon ata në planifikimin financiar, i bën të ndihen të pasigurt për të ardhmen dhe të kenë më pak besim që do të jenë në gjendje të absorbojnë goditjet financiare.

3. FILLESAT E EDUKIMIT DHE PROGRAMET EKZISTUESE TË BSH

32. Hartimi i Strategjisë së Bankës së Shqipërisë për Edukimin dhe Përfshirjen Financiare është mbështetur në vërtetimet dhe analizat e kryera nga Banka e Shqipërisë, në ekspertizën tonë shumëvjeçare, si dhe hartën e programeve ekzistuese të edukimit financiar në Shqipëri¹¹. Nevoja për të rritur njohuritë dhe aftësitë financiare në vendin tonë nuk është e re dhe një numër gjithnjë e në rritje institucionesh janë përfshirë në ofrimin e edukimit financiar në vend. Nga Harta e programeve edukative rezulton se në Shqipëri zhvillohen rreth 70 programe të edukimit financiar, që përfshijnë një gamë të gjerë iniciativash të zbatuara nga institucione publike, private dhe organizata të shoqërisë civile. Shumica e aktiviteteve janë të dizajnuara dhe zbatohen në baza ad-hoc, megjithatë disa prej tyre janë të vazhdueshme. Nismat nuk janë të koordinuara, në disa prej tyre vihet re fokus dhe karakteristika që mbivendosen, duke mos adresuar plotësisht nevojat ekzistuese të grupeve specifike të synuara.
33. Banka e Shqipërisë e ka renditur edukimin e publikut ndër objektivat e saj strategjike që nga viti 2003¹², me fokus kryesisht njohjen e institucionit të bankës qendrore, si dhe rritjen e transparencës dhe komunikimin e saj me publikun. Ndër instrumentet e përdorura në funksion të arritjes së këtij objektivi kanë qenë trajnimet për gazetarët e ekonomisë, të mësuesve të ekonomisë në gjimnaze, broshurat edukative etj¹³. Mbi bazën e kësaj eksperience, por edhe në përputhje edhe me zhvillimet globale në këtë fushë, natyrshëm u tranzitua drejt edukimit financiar të publikut. Në Strategjinë afatmesme të Bankës së Shqipërisë për periudhën 2013-2015¹⁴, rritja e kulturës financiare në vend përcaktohet si objektiv strategjik i Bankës së Shqipërisë, në funksion të objektivit kryesor dhe objektivave të ndërmjetëm të saj. Gjatë kësaj periudhe, numri dhe lloji i aktiviteteve u amplifikua dhe u pasurua me metoda bashkëkohore të mësimin interaktiv, i fokusuar kryesisht te nxënësit dhe studentët, pa lënë mënjanë publikun e gjerë. Të tilla kanë qenë: paketa mësimore për nxënësit e ciklit të ulët, moduli me zgjedhje të lirë për gjimnazistë mbi edukimin financiar, leksionet e Guvernatorit në universitete, fushatat ndërgjegjësuese, rrjetet sociale dhe multimediat, hapësirat edukative në Muzeun e Bankës së Shqipërisë etj.

¹¹ Dokumenti "Harta e programeve kryesore ekzistuese të edukimit financiar në Shqipëri" është përdorim të brendshëm.

¹² Dokumenti "Plan zhvillimi institucional për periudhën afatmesme, 2003-2005", Banka e Shqipërisë, 2002.

¹³ Për më shumë informacion, ndiqni linkun: https://www.bankofalbania.org/Muzeu_dhe_Edukimi/Edukimi/

¹⁴ "Strategjia afatmesme e Bankës së Shqipërisë për periudhën 2013-2015", Banka e Shqipërisë, 2012.

34. **Banka e Shqipërisë e ka formësuar bashkëpunimin institucional në fushën e edukimit përmes nënshkrimit të dy memorandumeve të bashkëpunimit, përkatësisht me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (2007) dhe Shoqatën Shqiptare të Bankave (2014).** Objekti i këtyre dokumenteve është nxitja e bashkëpunimit reciprok në fushën e edukimit të nxënësve të shkollave nëntëvjeçare dhe të mesme; si dhe të studentëve të universiteteve në fushat e ekonomisë, financës dhe bankës. Këto nisma bashkëpunimi kanë dhënë ndikim, por që ndikimi të jetë më i madh duhet që të ketë një koordinim dhe një bashkëpunim më të mirë me qëllim rritjen e kulturës financiare të gjithë individëve në Shqipëri për të forcuar më shumë qëndrueshmërinë dhe mirëqenien financiare të tyre.

SFIDAT E IDENTIFIKUARA PËR OFRIMIN E EDUKIMIT FINANCIAR

35. Të dhënat dhe analizat e bëra nga Banka e Shqipërisë, tregojnë një urgjencë dhe nevojë të përmirësimit të kulturës financiare në vend. Sot ka më shumë sfida dhe pasiguri në menaxhimin e financave personale në kushtet e zhvillimeve të vullshme të inovacioneve teknologjike dhe ofrimit të shërbimeve dhe produkteve financiare më komplekse. Ka më shumë produkte dhe shërbime financiare të ofruara dhe zgjedhja e tyre bëhet e vështirë. Gjithashtu në kushtet e ndryshimeve demografike, zgjedhja e një fondi të përshtatshëm pensioni do të përbëjë një sfidë për të gjithë në të ardhmen.
36. Rezultatet e marra nga Vrojtimi i Kulturës dhe Përfshirjes Financiare tregojnë që duhet të përmirësohen njohuritë bazë financiare të popullatës shqiptare, të racionalizohen vendimet dhe sjelljet e individëve mbi të ardhurat, kursimet, konsumin, investimet, huamarrjen, sigurimin, rrezikun dhe marrja e informacionet tek burimet e duhura. Të dhënat tregojnë se ka diferenca në indeksin e kulturës dhe në treguesit e përfshirjes financiare, sipas karakteristikave socio-ekonomike të individëve, që duhet të adresohen. Qasja në ndërtimin dhe koordinimin e përpjekjeve të ardhshme duhet të adresojë sfidat e mëposhtme:
- Segmentet më vulnerabël të popullsisë (gratë, banorët e zonave rurale dhe individët me të ardhura të ulëta) nuk kanë akses në edukim financiar cilësor dhe shumë programe ende nuk janë përshkallëzuar deri tek ata. Nivelet e ulëta të përfshirjes financiare të shoqëruara me nivelet e ulëta të kulturës financiare e bëjnë të vështirë kuptimin e rëndësisë së përfshirjes financiare nga segmentet vulnerabël.
 - Jo të gjitha përpjekjet aktuale për edukim financiar kanë arritur përmasa gjithëpërfshirëse dhe nuk ka matje të drejtpërdrejta të ndikimit të iniciativave. Për më tepër, aktivitetet e ofruara nuk janë të përshtatura me nevojat reale të përfituesit.

Qëllimi i kësaj strategjie është të koordinojë objektivat, programet, instrumentet dhe burimet njerëzore e financiare brenda BSH-së në përmbushje të objektivave strategjike për grupet e identifikuara të interesit.

4. KORNIZA E SBSHEPF

MISIONI

37. SBSHEPF është krijuar për të siguruar që individët në Shqipëri të fitojnë njohuritë e duhura financiare, të zotërojnë aftësitë, të mbajnë qëndrimet dhe të zhvillojnë sjelljet e duhura, të sakta dhe të zbatueshme financiare që u mundësojnë atyre të marrin vendime të mirinformuara, me synim final përmirësimin e mirëqenies dhe qëndrueshmërisë së tyre financiare.

VIZIONI

38. Vizioni i SBSHEPF është një shoqëri ku të gjithë individët kanë aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për të marrë vendimet e duhura financiare për sa i përket shpenzimit, kursimit, huamarrjes, investimit dhe sigurimit, në përputhje me gjendjen dhe objektivat financiare të gjithsecilit. Angazhimi në planifikim të shëndoshë financiar, besimi në sistemin financiar, njohja e të drejtave dhe detyrimeve të konsumatorit, shmangia e rreziqeve kibernetike, si dhe përdorimi efektiv i shërbimeve të rregulluara financiare si dhe i bankingut digjital, do të bëjë që individët, - të jenë në gjendje të përballojnë ngjarje të papritura në të ardhmen, si të rrisin qëndrueshmërinë dhe mirëqenien e tyre financiare.

OBJEKTIVAT KRYESORË

39. Objektivat kryesorë të Strategjisë së Bankës së Shqipërisë për Edukimin dhe Përfshirjen Financiare janë:

I. Miradministrimi i financave personale dhe huamarrja e zgjuar

Miradministrimi i financave personale është pjesë e jetës së përditshme.

Të gjithë individët kanë nevojë për njohuri dhe aftësi financiare për të shfrytëzuar sa më shumë të ardhurat e tyre, për të paguar faturat, përmbushur angazhimet e tjera financiare dhe për të marrë vendime racionale për shpenzimet bazuar në nevojat dhe prioritetet personale apo familjare.

II. Planifikimi dhe kursimi për të ardhmen

Vendosja e objektivave financiarë dhe identifikimi i mënyrave për t'i realizuar ato, përbën një komponent të rëndësishëm të kulturës financiare. Objektivat financiarë mund të jenë afatshkurtër, siç është blerja e një makine, apo afatgjatë, si për shembull, planifikimi për arsimim, blerja e

një shtëpie, apo dalja në pension, arritja e të cilave kërkon ndërmarrjen e hapave konkretë. Për më tepër kërkohet që konsumatorët të kenë njohuri të mira për produktet dhe shërbimet financiare, për të dalluar cilësitë, përfitimet, kostot dhe rreziqet që i shoqërojnë ato.

III. Parandalimi dhe mbrojtja e konsumatorit ndaj ndryshimeve dhe abuzimeve financiare

Çdokush mund të bjerë viktimë e mashtrimit financiar. Individët duhet të jenë të vetëdijshëm mbi hapat që duhet të ndjekin, si t'i minimizojnë rreziqet, si dhe ku duhet të drejtohen për të kërkuar ndihmë nëse mendojnë se janë viktimë e mashtrimit.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

40. Për të arritur objektivat e Strategjisë, duhet të krijohet një mjedis që vendos kushtet dhe inkurajon nisma të koordinuara e efektive të edukimit dhe përfshirjes financiare. Pesë shtyllat, ku do të mbështetet strategjia, janë:
 - a. Edukimi i brezit të ri kryesisht përmes sistemit arsimor. Studimi i kurrikulave arsimore lidhur me edukimin financiar dhe ofrimi i njohurive financiare shtesë për ta pajisur nxënësin me aftësi të dobishme dhe të qëndrueshme në kohë;
 - b. Rritja e përdorimit të mjeteve dhe burimeve të paanshme të informacionit financiar dhe e iniciativave për një publik të gjerë. Përveç kanaleve të tjera të komunikimit, publikut do t'i vijë në ndihmë krijimi i një portali unik me informacion financiar të plotë dhe cilësor që i qaset atij sipas fazave të jetës;
 - c. Ofrimin të udhëzimeve dhe këshillimit të shënjestruar dhe me cilësi, drejtuar kryesisht segmenteve vulnerabël të popullsisë;
 - d. Kërkimi i sinergjive në organizimin e aktiviteteve dhe programeve të përbashkëta me partnerët, me qëllim maksimizimin e ndikimit përmes një plani të detajuar veprimi;
 - e. Përmirësimi i monitorimit dhe vlerësimit. Vijimi i matjeve të nivelit të kulturës financiare dhe rritja e numrit të programeve edukative të monitoruara dhe vlerësuara për të matur efektivitetin e tyre.

VIZIONI

Përmirësimi i mirëqenies financiare të të gjithë individëve në Shqipëri

Objektivi I:

Miradministrimi i financave personale dhe huamarrje e zgjuar

Objektivi II:

Planifikimi dhe kursimi për të ardhmen


Objektivi III:

Parandalimi dhe mbrojtja e konsumatorit nga mashtrimet dhe abuzimet financiare

STRATEGJIA

Mobilizimin dhe angazhimin e sektorit publik dhe privat për të rritur kulturën financiare të popullsisë për të arritur objektivat kryesorë

Bazuar në prioritetet e mëposhtme:




5. KUADRI PËR VEPRIM I SBSHEPF

41. Kuadri i veprimit të SBSHEPF është hartuar duke u bazuar në diagnostikimin e plotë të tregut, në identifikimin e nevojave dhe sfidave në nivel individual, sektorial dhe kombëtar, si dhe në kuadrin ligjor dhe rregullator të Bankës së Shqipërisë. Ai përmban tre fusha gjithëpërfshirëse ndërhyrjeje: (i) mundësimin e të kuptuarit, aksesit dhe përdorimit të shërbimeve financiare të rregulluara bazuar në vendime të informuara; (ii) mbrojtjen e konsumatorëve nga praktikrat e padrejta dhe mashtruese, duke rritur besimin në

shërbimet financiare të rregulluara; dhe (iii) fuqizimin e segmenteve vulnerabël të konsumatorëve me iniciativa të përshtatshme për ta. Për të përmbushur sa më sipër, SBSHEPF bazohet në tre faktorë nxitës themeltarë: (i) marrëveshje dhe koordinim të fortë ndërinstitucional; (ii) qasje me në qendër individin; dhe (iii) të dhëna dhe kërkim shkencor.

Figura 3: Kuadri për Veprim i SBSHEPF



42. Fusha e parë e ndërhyrjes së SBSHEPF është MUNDËSIMI i të kuptuarit, aksesit dhe përdorimit të duhur të shërbimeve financiare të rregulluara bazuar në vendime të informuara. Më konkretisht, kjo përfshin nxitjen e aksesit në shërbimet financiare të rregulluara dhe rritjen e besimit ndaj tyre, duke adresuar paragjykimet dhe keqkuptimet që rrjedhin nga mungesa e informacionit. Për më tepër, SBSHEPF synon të promovojë përdorimin efektiv të shërbimeve dhe produkteve financiare të rregulluara për të ndihmuar të gjithë të arrijnë objektivat e tyre financiarë. Për këtë qëllim, përpjekjet për edukim financiar do të përqendrohen në promovimin e: huamarrjes së zgjuar, shfrytëzimit të instrumenteve efikase të pagesave, vlerës në kohë të parasë dhe investimit për të ardhmen nëpërmjet kursimeve dhe mjeteve të tjera. Së fundi, përpjekjet për edukim financiar do të ecin paralelisht me risitë e tregut, veçanërisht në drejtim të shërbimeve financiare digjitale. Si të tilla, përpjekjet për edukim financiar do t'u mundësojnë përdoruesve aksesin dhe përdorimin e shërbimeve financiare digjitale në mënyrë të sigurt.

43. **Së dyti, SBSHEPF-i synon të MBROJË konsumatorët nga praktikat mashtruese dhe t'i informojë mbi rreziqet e inovacionit në shërbimet financiare.** Në praktikë, kjo kërkon shpërndarjen e njohurive për të drejtat, detyrimet dhe rrugët për zgjidhjen e ankesave, si dhe promovimin e standardeve e praktikave të drejta dhe etike të industrisë.
44. **Fusha e tretë kyçe e ndërhyrjes fokusohet në FUQIZIMIN e të gjitha segmenteve të popullsisë dhe pajisjen e tyre me aftësi dhe njohuri e duhura financiare.** SBSHEPF thekson nevojën për vëmendje të veçantë ndaj popullatave të marginalizuara dhe të përjashtuarve financiarisht, përmes ndërhyrjeve të përshtatura për ta. Sipas të dhënave të Vrojtimit për Matjen e Kulturës dhe Përfshirjes Financiare, ekziston një nevojë e qartë për të forcuar iniciativat e edukimit financiar dhe për të vepruar në mënyrë strategjike për arritjen e grupeve të individëve me nivel më të ulët të kulturës dhe përfshirjes financiare.
45. **Përsa i përket bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstytucional, BSH do të punojë për intensifikimin e bashkëpunimit me aktorë publikë dhe privatë të angazhuar në edukimin e publikut dhe identifikimin e sinergjive të reja, me synim ngritjen e këtyre përpjekjeve në nivel kombëtar.** Një sërë organizmash ndërkombëtarë rekomandojnë adresimin e rritjes së kulturës financiare nga institucionet publike e private përmes hartimit dhe zbatimit të strategjive kombëtare të edukimit financiar¹⁵.
46. **Sipas qasjes me në qendër individin, iniciativat e edukimit financiar hartohen bazuar në një vlerësim të plotë të nevojave të popullsisë së synuar dhe në përputhje me vlerësimin e ndikimit të tyre.** Ky proces zakonisht përfshin identifikimin e mangësive, nevojave, kontekstit dhe rezultateve të sjelljes, për të ndihmuar konsumatorin me informacion për përmirësimin e përvojave të përsëritura në kohë dhe rezultateve të tyre. Gjatë gjithë procesit, do të ndiqen praktikat e mira dhe udhëzimet ndërkombëtare për të siguruar efikasitet dhe për të minimizuar rreziqet.
47. **Si nxitëse të objektivave më të gjerë të zhvillimit, përpjekjet e edukimit financiar duhet të lidhen dhe të krijojnë sinergji me prioritetet e politikave kombëtare, por duke u bazuar në të dhëna dhe analiza të plota kërkimore shkencore.** Mbështetja në të dhëna, fakte dhe analiza sa më të plota kërkimore do të shërbejë për të vlerësuar hendeqet, diferencat që ekzistojnë dhe për të matur ndikimin e programeve të ndërmarra.

¹⁵ G20/OECD ka miratuar agjendën e edukimit financiar duke prezantuar një sërë parimesh të nivelit të lartë: Përfshirja Financiare Novatore (2010); Mbrojtja Financiare e Konsumatorit (2011); Strategjitë Kombëtare për Edukimin Financiar (2012); Rekomandimi i Këshillit të OECD për Kulturën Financiare, OECD/LEGAL/0461; dhe Parimet e nivelit të lartë të G20 për Përfshirjen Financiare Digjitale (2021).

48. Plani i veprimit i SBSHEPF i paraqitur në fund të kësaj strategjie është hartuar në përputhje me objektivat kryesorë dhe strategjike të saj dhe praktikisht i zbërthen ato në bashkësinë e aktiviteteve sipas tematikave dhe grupeve të interesit. Ai synon të adresojë: edukimin e brezit të ri kryesisht përmes sistemit arsimor; rritjen e përdorimit të mjeteve dhe burimeve të paanshme të informacionit financiar, si dhe shtimin e iniciativave për një publik të gjerë; ofrimin e udhëzimeve dhe këshillimit të shënjestruar dhe me cilësi, drejtuar kryesisht segmenteve vulnerabël të popullsisë; kërkimin e sinergjive në organizimin e aktiviteteve dhe programeve të përbashkëta; përmirësimin e kërkimit, monitorimit dhe vlerësimit përmes ofrimit të udhëzimeve dhe këshillimit të personalizuar dhe me cilësi. Këta objektiva do të realizohen përmes aktiviteteve të mirëmenduara informuese dhe edukative, të përshtatura sipas nevojave të audiencës së përzgjedhur.

RREGULLIMI INSTITUCIONAL

49. SBSHEPF do të zbatohet nga një grup pune ndërdepartamental, i krijuar nga përfaqësues të departamenteve të ndryshme të BSH (DK, DSPKF, DPM, DSF, DM, DOM, DE, DTI), të cilët do të angazhohen në përgatitjen dhe ofrimin e programeve të edukimit financiar, në varësi të mandatit dhe fushës së tyre të ekspertizës. Ndjekja dhe mbarëvajtja e Strategjisë do të koordinohet nga Departamenti i Kërkimeve, i cili do të përcaktojë tematikat dhe aktivitetet në përmbushje të misionit të SBSHEPF.

BUXHETI

50. Financimi i programeve dhe aktiviteteve specifike të Planit të Veprimit të BSH do të sigurohet si rregull nga buxheti institucional. Megjithatë, SBSHEPF ka qasje fleksibël ndaj financimit dhe fondet mund të vijnë edhe nga burime të ndryshme, si për shembull nga institucione publike, organizata private dhe apo të shoqërisë civile për të financuar përpjekjet apo projektet e përbashkëta. Disa lloje financimi përfshijnë (por nuk kufizohen në):
- a. Vetëfinancim. BSH financon programet e saj të edukimit financiar sipas mandatit përkatës, me burime të brendshme.
 - b. Financimi i përbashkët. Disa institucione/organizata partnere bashkëfinancojnë një program ose iniciativë specifike.
 - c. Donatorët. Donatorë të ndryshëm mund të jenë të interesuar të mbështesin aktivitetet e edukimit financiar të Bankës së Shqipërisë.

6. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

51. **Një kornizë e qëndrueshme monitorimi dhe vlerësimi është domosdoshmëri për zbatimin e suksesshëm të SBSHEPF.** Më konkretisht, ajo do të mundësojë gjurmimin e progresit me kalimin e kohës, identifikimin e pengesave dhe vlerësimin e impaktit të synuar të aktiviteteve. Programet kryesore do të vlerësohen për sa i përket efikasitetit, ndikimit dhe shkallës në të cilën ato kontribuojnë në objektivat strategjike. Për më tepër, rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit ofrojnë bazën për planifikimin e aktiviteteve të ardhshme.
52. Për matjen e progresit të SBSHEPF, BSH do të zhvillojë, mbajë dhe ndjekë ecurinë e projekteve të edukimit financiar dhe programeve të lidhura me to dhe do të monitorojë një sërë rezultatesh për të siguruar që zbatimi i nismave të edukimit financiar është në rrugën e duhur. Në këtë fazë të parë të Strategjisë, **monitorimi dhe vlerësimi i impaktit të SBSHEPF do të kryhet përmes treguesve si më poshtë:**
- Numri i shkollave të përfshira në programet e edukimit financiar;
 - Numri i mësuesve të trajnuar;
 - Numri i nxënësve të përfshirë;
 - Numri i individëve që do të aksesojnë faqen zyrtare të internetit dhe rrjetet sociale të BSH;
 - Numri i individëve të ndihmuar nga programet e tjera të orientimit dhe mbështetjes së kulturës financiare;
 - Barometri lidhur me cilësinë e programeve ose aktiviteteve të ofruara;
 - Numri i aktiviteteve të realizuara (nga Plani i Veprimit);
 - Rezultatet e vërtetimeve dhe matjeve të efektshmërisë së programeve të edukimit financiar;
 - Rezultatet e studimeve dhe vlerësimeve kërkimore, si p.sh. të Vërtimit për Matjen e Kulturës Financiare.

7. VEPRIMET PRIORITARE

60. SBSHEPF është një dokument subjekt ndryshimi, i cili gjatë vitit të parë të zbatimit i jep përparësi disa projekteve të përzgjedhura. Projektet do të përzgjidhen sipas ndikimit, praktikave më të mira dhe prioriteteve në varësi të nevojave në zhvillim të tregut.
61. Bazuar në ecurinë e planit të veprimit dhe progresin drejt objektivave kryesorë, në fund të vitit 2024 do të kryhet një rishikim afatmesëm i zbatimit të SBSHEPF, për të vlerësuar progresin dhe identifikuar sfidat dhe mundësitë e reja. SBSHEPF do të rivlerësohet përmes një procesi konsultativ për të përcaktuar veprime të mëtejshme ose masa korigjuese që sigurojnë efektivitetin e saj.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKË		
1. Edukimi i brezit të ri kryesisht përmes sistemit arsimor	2. Rritja e përdorimit të mjeteve dhe burimeve të paanshme të informacionit financiar dhe e iniciativave për një publik të gjerë	3. Rritja e kulturës financiare të popullatës përmes ofrimit të udhëzimeve dhe këshillimit të personalizuar dhe me cilësi
Plani i veprimit		
1.1 Studimi i kurrikulave arsimore dhe ofrimi i njohurive financiare shtesë për ta pajisur nxënësin me aftësi të dobishme dhe të qëndrueshme në kohë 1.2 Rishikimi i tekstit mësimor për gjimnazistë "Financat personale në duart tuaja" dhe promovimi i tij në shkolla 1.3 Zhvillimi i trajnimeve për mësues me qëllim rritjen e kompetencës dhe angazhimit të tyre për mësimdhënien e edukimit financiar 1.4 Shtimi i aktiviteteve edukuese për nxënës dhe studentë	2.1 Krijimi i një portali unik për edukimin financiar të individëve, i organizuar sipas fazave të jetës, i cili do të shërbejë si burim bazë informacioni financiar 2.2 Përcjellja e informacionit përmes kanalesh alternative për të targetuar grupe të ndryshme interesi (media sociale, radio, podcaste, burime të tjera të paanshme informacioni) 2.3 Promovimi i programeve të edukimit financiar të bazuara në vendin e punës 2.4 Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese drejtuar publikut të gjerë për promovimin e rëndësisë së kulturës financiare	3.1 Nxitja e praktikave më të mira në ofrimin e programeve që ofrojnë udhëzime të personalizuar dhe këshillim, veçanërisht për grupet vulnerabël 3.2 Përmirësimi i udhëzimeve dhe këshillimit për të përbushur më mirë nevojat e individëve 3.3 Ndërtimi i kapaciteteve të ndërmjetësve për të ofruar programe të edukimit financiar për individët, familjet dhe komunitetet e papërfshira financiarisht dhe/ose vulnerabël
TREGUESIT KRYESORË		
<ul style="list-style-type: none"> • Numri i shkollave të përfshira në programet e edukimit financiar • Numri i mësuesve të trajnuar • Numri i nxënësve të përfshirë 	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i individëve që aksesojnë faqen e BSH, rrjetet sociale të saj • Numri i individëve që përdorin burime të paanshme informacioni • Numri i individëve të përfshirë në programet edukuese dhe ose fushatat ndërgjegjësuese • Rezultatet e vrojtimeve dhe matjeve të efektshmërisë së programeve të edukimit financiar 	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i individëve të ndihmuar nga programet e orientimit dhe këshillimit • Vlerësime nga ndërmjetësit në lidhje me udhëzimet dhe këshillimin e ofruar • Rezultatet e studimeve dhe vlerësimeve kërkimore
4. Kërkimi i sinergjive në organizimin e aktiviteteve dhe programeve të përbashkëta	5. Përmirësimi i kërkimit, monitorimit dhe vlerësimit	
Plani i veprimit		
4.1 Identifikimi i partnerëve/aktorëve të rinj potencialë për zbatimin e planit të veprimit të SBSHEPF 4.2 Përmirësimi i bashkërendimit ndërmjet ofruesve të programeve të edukimit dhe ofruesve të shërbimeve 4.3 Rritja e kapaciteteve njerëzore të përfshira në zbatimin e SBSHEPF, duke mësuar nga praktikat më të mira ndërkombëtare me qëllim rritjen e cilësisë së programeve të edukimit financiar në nivel kombëtar	5.1 Pjesëmarrja në studime kërkimore dhe raporte ndërkombëtare të fushës 5.2 Kryerja e matjes së kulturës dhe përfshirjes financiare të popullatës në nivel kombëtar 5.3 Rritja e aksesit në mjete dhe burime për të mbështetur praktikën e mira të monitorimit dhe vlerësimit 5.4 Nxitja e praktikave të mira duke rritur aksesin e ekspertëve të fushës për të identifikuar iniciativat e efektshme	
TREGUESIT KRYESORË		
<ul style="list-style-type: none"> • Numri i bashkëpunëtorëve (partnerë/aktorë të rinj potencialë) • Numri i aktiviteteve/ programeve të përbashkëta të edukimit financiar • Numri i pjesëmarrjeve në aktivitete ndërkombëtare në fushën e edukimit financiar 	<ul style="list-style-type: none"> • Të dhënat dhe indikatorë mbi matjen e kulturës dhe përfshirjes financiare të të rriturve në Shqipëri • Numri i programeve të edukimit financiar të monitoruara dhe vlerësuara • Vlerësime nga ofruesit e edukimit financiar mbi efektshmërinë e programeve dhe praktikave më të mira 	

PLANI I VEPRIMIT TË SBSHEPF, 2024-2026¹⁶

Nr.	Masa	Lloji i aktivitetit	Institucioni/njësia përgjegjëse	Institucioni mbështetës	Objektivi/qëllimi	Grupi i interesit	Treguesi i performancës	Afati
1. Edukimi i brezit të ri								
1.	Organizimi i Ditës Ndërkombëtare të Kursimit	Orë mësimore	BSH/DK	Shkolla 9-vjeçare	Edukimi financiar i nxënësve të shkollave 9-vjeçare mbi rëndësinë e kursimit	Nxënës 9-vjeçare	Numri i nxënësve dhe shkollave të përfshira	Tetor 2024-2026
2.	Çmimi i Guvernatorit për Diplomën më të mirë	Konkurs	BSH/DK-KG		Mbështetja dhe incentivimi i studentëve për punë shkencore mbi tema të lidhura me bankungun qendror, financat dhe ekonominë	Studentë	Numri i studentëve të përfshirë	Dhjetor 2024-2026
3.	Shpërndarja e Modulit me zgjedhje të lirë "Financat personale në duart tuaja"	Program mësimor	BSH/DK	Gjimnaze	Edukimi dhe aftësimi financiar i nxënësve gjimnazistë, si pjesë e kurrikulës arsimore me zgjedhje të lirë	Gjimnazistët	Numri i nxënësve dhe shkollave të përfshirë	Shtator 2024-2026
4.	Leksione në universitete	Leksione	BSH/GP	Universitete	Rritja e njohurive financiare të studentëve mbi tema të lidhura me bankungun qendror, financat dhe ekonominë	Studentë	Numri i studentëve dhe i universiteteve të përfshirë	2024-2026
5.	Organizimi i Javës së Parasë, (konurse, orë mësimore, leksione, vizita në Muze/banka etj.)	Aktivitete të ndryshme	BSH/DK	MAS, AAB, ASD, shkolla	Ndërgjegjësimi dhe rritja e kulturës financiare të fëmijëve dhe të rinjve, në kuadër të fushatës globale	Nxënës 9-vjeçare, gjimnazistë dhe studentë	Numri i nxënësve dhe shkollave të përfshirë Numri i studentëve dhe i universiteteve të përfshirë	Mars 2024-2026
6.	Rishikimi i tekstit mësimor për gjimnazistë "Financat personale në duart tuaja"	Program mësimor	BSH/DK	Gjimnaze	Përditësimi dhe pasurimi i tekstit mësimor me qëllim kultivimin e kulturës financiare të gjimnazistëve dhe aftësimi i tyre për të ardhmen	Gjimnazistët	N/A	Gusht 2024

¹⁶ Plani i veprimit për periudhën 2025-2026 do të rishikohet në fund të vitit 2024, në varësi të ecurisë dhe realizimit të aktiviteteve të dyvjeçarit të parë dhe treguesve të performancës së tyre.

Nr.	Masa	Lloji i aktivitetit	Institucioni/njësia përgjegjëse	Institucioni mbështetës	Objektivi/qëllimi	Grupi i interesit	Treguesi i performancës	Afati
7.	Shpallja e Tetorit – Muaj të Kursimit dhe organizimi i aktiviteteve të ndryshme për nxënës dhe studentë	Aktivitete të ndryshme	BSH/GP	MAS, AAB, ASD, shkolla	Ndërgjegjësimi dhe rritja e kulturës financiare të fëmijëve dhe të rinjve	Nxënës 9-vjeçarë dhe gjimnazistë	Numri i nxënësve dhe shkollave të përfshirë Numri i studentëve dhe i universiteteve të përfshirë	Tetor 2024
2. Rritja e përdorimit të mjeteve dhe burimeve të paanshme të informacionit financiar								
8.	Hartim dhe publikim artikulli për rritjen e ndërgjegjësimit të grave mbi rëndësinë e kulturës financiare	Artikull në revistë	BSH/ZvGuv I – DK	Media	Ndërgjegjësimi i publikut ose i grave mbi rëndësinë e kulturës financiare në funksion të fuqizimit e rritjes së mirëqenies së tyre financiare	Gratë/publiku i gjerë	Tirazhi i revistës	2024
9.	Postime në rrjete sociale për çështje të edukimit financiar	Postim	BSH/DK		Rritja e kulturës financiare të publikut të gjerë	Publiku i gjerë	Numri i postimeve dhe reagimeve	2024-2026
10.	Hartimi i një fjalorthi me termat më të përdorur financiarë për publikun e gjerë	Publikim fjalori	BSH/DK		Vënia në dispozicion të publikut të gjerë të një informacioni profesional dhe të pavarur, të shkruar me një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme	Publiku i gjerë		2024
11.	Prezantimi i rezultateve të marra nga "Aksesi në financim i ndërmarrjeve"	Takim	BSH/DK	AAB, AMA, Dhomat e Tregtisë	Njohja e ofruesve të shërbimeve financiare me gjetjet e anketës dhe me nevojat e ndërmarrjeve për financim apo produkte financiare	Publiku i gjerë	Numri i pjesëmarrësve	2024
12.	Prezantimi i rezultateve të marra nga vrojtimi "Matja e kulturës dhe përfshirjes financiare"	Takim	BSH/DK	AAB, AMA	Njohja e ofruesve të shërbimeve financiare me gjetjet e anketës për matjen e kulturës financiare të individëve me qëllim rritjen e përfshirjes financiare të tyre	Publiku i gjerë	Numri i pjesëmarrësve	2024
13.	Prezantimi i rezultateve të marra nga "Vrojtimi i pasurisë së familjeve"	Takim	BSH/DK	AAB, AMA	Njohja e ofruesve të shërbimeve financiare me gjetjet e anketës dhe me nevojat familjeve për financim apo produkte financiare	Publiku i gjerë	Numri i pjesëmarrësve	2024

Nr.	Masa	Lloji i aktivitetit	Institucioni/njësia përgjegjëse	Institucioni mbështetës	Objekti/qëllimi	Grupi i interesit	Treguesi i performancës	Afati
3. Rritja e kulturës financiare të popullatës përmes ofrimit të udhëzimeve dhe këshillimit të personalizuar dhe me cilësi								
14.	Pjesëmarrja në panairë "Festivali i Aftësive, Punës dhe Karrierës Expo"	Workshop	BSH/DK	Expocity Albania, Albanian Skills	Aftësimi financiar i të rinjve dhe të rriturve në kuadër të të mësuarit përgjatë gjithë jetës, punësimit, këshillimit dhe edukimit në karrierë	Popullata e rritur	Numri i pjesëmarrësve	2024-2026
15.	Trajnime për gratë	Trajnime	BSH/GP	Shoqatat për mbrojtjen e të drejtave grave	Fuqizimi i grave përmes rritjes së kulturës dhe përfshirjes financiare të tyre	Gratë	Numri i pjesëmarrësve Numri i aktiviteteve	2024-2026
16.	Trajnime për sipërmarrësit e rinj dhe NMVM	Trajnime	BSH/GP	Dhomat e tregtisë, AAB	Rritja e kulturës financiare të sipërmarrësve të rinj dhe NMVM, me qëllim aftësimin dhe rritjen e përfshirjes së tyre financiare	Sipërmarrësit e rinj dhe NMVM	Numri i pjesëmarrësve Numri i aktiviteteve	2024-2026
4. Kërkimi i sinergjive në organizimin e aktiviteteve dhe programeve të përbashkëta								
17.	Përfitimi i asistencës teknike nga homologë dhe ekspertë ndërkombëtarë	Takime pune	BSH/SECOMFE, MAS, AMF, AAB, JAA, AMA, ASD		Rritja e ekspertizës dhe pasurimi i programeve edukuese të BSH	N/A	Numri i bashkëpunimeve	2024-2026
18.	Ngritja e Grupit Ndërdepartament të Punës (GNP)	Akt rregullator	BSH/DK		GNP do të jetë i ngarkuar me hartimin dhe përcjelljen e programeve të edukimit	N/A	N/A	2024
19.	Vendosja e urave të komunikimit dhe rritja e numrit të bashkëpunëtorëve	Komunikim/takime	BSH/DK		Rritja e bashkëpunimeve me qëllim rritjen e shtrirjes së aktiviteteve dhe pasurimin e tyre		Numri i bashkëpunëtorëve	2024-2026
20.	Nxitja e aktorëve publikë e privatë për të bashkërenduar përpjekjet në fushën e edukimit financiar	Komunikim/takime	BSH	MF, MAS, AMF, AAB, JAA, AMA, ASD etj.	Ngritja në nivel kombëtar e çështjes së edukimit financiar në vend	N/A	N/A	2024-2026

Nr.	Masa	Lloji i aktivitetit	Institucioni/njësia përgjegjëse	Institucioni mbështetës	Objektivi/qëllimi	Grupi i interesit	Treguesi i performancës	Afati
5. Përmirësimi i kërkimit, monitorimit dhe vlerësimit								
21.	Vrojtimi për matjen e kulturës dhe përfshirjes financiare të popullatës, 2023	Anketë	BSH/DK	INSTAT INFE/OECD	Analiza mbi gjendjen financiare të rriturve në Shqipëri, si dhe identifikimi i grupeve më vulnerabël.	Popullata e rritur	N/A	2024
22.	Përdorimi i Vrojtimi për matjen e "Aksesit në financim të ndërmarrjeve" për identifikimin e sektorëve dhe ndërmarrjeve më vulnerabël në terma të kulturës financiare	Anketë	BSH/DK-DSF	INSTAT	Identifikimi i grupeve vulnerabël	Ndërmarrjet	N/A	2024
23.	Përdorimi i anketës "Vrojtimi i pasurisë së familjeve" për të krijuar tregues mbi qëndrueshmërinë dhe vulnerabilitetin e familjeve shqiptare.	Anketë	BSH/DK	INSTAT	Mbledhja e të dhënave individuale mbi familjet shqiptare për të analizuar ndër të tjera qëndrueshmërinë dhe brishtësinë financiare të familjeve	Familjet	N/A	2005

AKRONIME

AAB	Shoqata Shqiptare e Bankave
AMA	Shoqata Shqiptare e Mikrofinancës
ASD	Agjencia e Sigurimit të Depozitave
AMF	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
BB	Banka Botërore
BSH	Banka e Shqipërisë
JAA	Junior Achievement of Albania
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
NMVM	Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
SECO	Sekretariati Shtetëror i Çështjeve Ekonomike të Zvicrës
SBSHEPF	Strategjia e Bankës së Shqipërisë për Edukimin dhe Përfshirjen Financiare
SKPW	Strategjia Kombëtare e Pagesave me Vlerë të Vogël



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 7, datë 24.1.2024

**PËR
MIRATIMIN E DELEGIMIT TË KOMPETENCËS
PËR NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT MIDIS BANKËS
SË SHQIPËRISË DHE AKADEMISË SË SIGURISË**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 53, pika 4, paragrafi i fundit i ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, neneve 28 dhe 29 të ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe bazuar në propozimin e Departamentit të Sigurimit dhe Mbrojtjes dhe të Guvernatorit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të autorizojë Zëvendësguvernatorin e Dytë, Znj. Natasha Ahmetaj, për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Akademisë së Sigurisë.
2. Ngarkohet Departamenti i Sigurimit dhe Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas publikimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO